UDHËZIM
Nr. 75, datë 13.3. 2014

PËR PROCEDURAT QË NDIQEN PËR ADMINISTRIMIN E AUTOMJETEVE DHE MOTOMJETEVE QË KALOJNË NË REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT SI PASOJË E KONFISKIMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 11, pikës 1/"a", "b" të nenit 12 dhe nenit 201 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neneve 2, 4/"c", 6, 10 dhe 11 të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", si dhe pikës 2/"b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", me qëllim që të ketë unifikim në procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për pranimin dhe marrjen në dorëzim të automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit (më poshtë mjetet e konfiskuara).

2. Mjetet e konfiskuara nga Policia, do të pranohen dhe merren në dorëzim së bashku me dosjen respektive të secilit mjet përgatitur nga Policia sipas rregullave të caktuara për këtë qëllim, pranë ambienteve të drejtorisë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit që korrespondon me territorin përkatës, me procesverbal për secilin mjet, të nënshkruar respektivisht nga përfaqësuesit e Policisë dhe të Rezervave Materiale të Shtetit.

3. Në marrëveshje mes palëve, dorëzimi mund të bëhet edhe direkt *"de jure"* në pikat ekzistuese të ruajtjes së mjeteve në përputhje me dokumentacionin respektiv të dosjes së secilit mjet të konfiskuar dhe mjetet do të vijojnë të ruhen pranë pikave ekzistuese të ruajtjes deri në përfundimin e procedurave të tjetërsimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

4. Për kategorizimin e mjeteve të konfiskuara, drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit ngre komisionin përkatës. Komisionet për kategorizimin përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht specialistë të lartë të fushës (inxhinier mekanik, financierë etj.). Kur këta specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore. Komisioni për kategorizimin e mjeteve, duke marrë për bazë këto kritere: viti i prodhimit; kilometrat e përshkruar; gjendja teknike e motorit; normat e harxhimit të karburantit për 100 km; gjendja teknike e pjesëve xhenerike; sistemin elektrik; pamja e jashtme e mjetit dhe tapiceria, vendos për:

a) mjete motorike që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim;

b) mjete motorike që do të administrohen në skrap, duke përcaktuar njëkohësisht edhe peshën fizike respektive.

Për mjetet e marra në dorëzim sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, komisioni për kategorizimin e realizon veprimtarinë në pikën ekzistuese të ruajtjes së mjeteve.

Për efekt kontabiliteti, mjetet e konfiskuara pas marrjes në dorëzim nga Rezervat Materiale të Shtetit, do të kontabilizohen me vlerën 1 (një) lek.

5. Komisioni i kategorizimit për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve që do të administrohen në skrap, peshës teknike bosh të gjendur në librezat teknike apo pllaketat metalike që përmbajnë të dhënat e peshës bosh të mjetit, i zbret një koeficient të matshëm me % (përqindje), si diferencë që përfshin peshën e xhamave; pjesëve plastike të kruskotit, sedilieve, tapiceri, goma, parakolpe, stopa, fenerë etj., që, për shkak të natyrës, nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve, përkatësisht për:

- automjetet nga 3.5 tonë deri në 10 tonë;
- automjetet kamioncina deri në 3.5 tonë;
- automjetet tip fugon dhe fuoristradë;
- automjetet tip autoveturë.

Ministri ngre grupin e punës të përbërë nga 5 anëtarë, specialistë të lartë të fushës (inxhinier mekanik, inxhinierë elektrikë financierë etj.) për përcaktimin e koeficientit të matshëm me % (përqindje), si diferencë që përfshin peshën e xhamave; pjesëve plastike të kruskotit, sedilieve, tapiceri, goma, parakolpe, stopa, fenerë etj., që, për shkak të natyrës, nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve. Për këtë qëllim grupi i punës, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, përgatit relacionin teknik, i cili miratohet nga Ministri. Pas miratimit, relacioni teknik i dërgohet

Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për procedura të mëtejshme.

Në rast mungese të librezës teknike apo pllaketës metalike që përmban të dhënat e peshës bosh të mjetit, të dhënat për peshën bosh të mjetit kërkohen zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor duke i vënë në dispozicion kësaj të fundit listën e mjeteve me të dhënat e plota lidhur me markën, tipin, llojin e mjetit, lëndën djegëse, vitin e prodhimit dhe fuqinë motorike.

6. DPRMSH-ja i dërgon Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol Tirana listën e mjeteve të kategorizuara për qarkullim me numrat e shasisë për konfirmim, nëse mjeti është në kërkim. Në rast se mjeti nuk rezulton në kërkim, u nënshtrohet procedurave të shitjes me ankand publik. Në rast se mjeti rezulton në kërkim, vijon gjendje pranë Rezervave të Shtetit për procedura të mëtejshme.

7. Ministri miraton procedurat e shitjes me ankand të mjeteve të konfiskuara të kategorizuara sipas pikës 4/a të këtij udhëzimi, ndërsa procedurat e shitjes me ankand të mjeteve të konfiskuara sipas pikës 4/b të këtij udhëzimi, miratohen nga drejtori i përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit.

8. Lista e mjeteve motorike që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, që do të shiten me ankand, së bashku me të dhënat përkatëse, për vitin e prodhimit, markën dhe modelin, i dërgohet nga DPRMSH-ja zyrës doganore më të afërt, e cila përdor si burim informacioni buletinet që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Vlerës së dërguar nga zyra doganore i zbritet 50% si koeficient amortizimi për shkak të përdorimit të mjetit. Vlera e mbetur është vlera e mjetit të kategorizuar për qarkullim, e cila do të jetë dhe vlera fillestare e ankandit. Të ardhurat kalojnë në buxhetin e shtetit.

9. Mjetet motorike që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, të cilat u janë nënshtruar procedurave të shitjes me ankand publik për tri herë me radhë dhe procedurat e ankandit kanë dështuar, të trajtohen për skrap. Këto mjete dhe mjetet e kategorizuara sipas pikës 4/b të këtij udhëzimi u shiten shoqërive me objekt veprimtarie që sigurojnë tjetërsimin në skrap, shkatërrimin/demolimin e mjeteve për skrap apo për shkrirje metalesh. Çmimi i shitjes përcaktohet për kilogram për skrap. Edhe për këto raste veprohet sipas pikës 5 të këtij udhëzimi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit pas përfundimit të procedurave të ankandit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e tyre. Të ardhurat kalojnë në buxhetin e shtetit.

10. Mjetet e kaluara në Rezervat Materiale të Shtetit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 203 i Kodit rrugor, shiten nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Për këtë rast, në përfundim të procedurave të shitjes Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vlerën e realizuar nga shitja me ankand. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në rast se pas shitjes së mjetit:

- evidenton diferencë të mundshme në lekë, ia kthen atë shkelësit;

- evidenton se vlera e shitjes rezulton më e ulët se vlera e gjobës, atëherë vlera e shitjes konsiderohet e ardhur përfundimtare në buxhetin e shtetit dhe kryen sistemimin e veprimeve dokumentare dhe të rakordimit të kontabilitetit.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtoritë rajonale në varësi të saj, për zbatimin e këtij udhëzimi.

12. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme ndjek zbatimin e këtij udhëzimi.

Me këtë udhëzim të njihet Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri